



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 908/7 prot.,

Datë 08.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 484/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtare
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “G.A.C.” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur - Punë publike (kontratë me çelsa në dorë)*” me Nr. REF-76024-02-12-2026, me objekt: “Furnizimi me ujë i zonës së Gjirit të Lalzit (*Kontratë me çelsa në dorë*)” me fond limit 65.000.000 (*Gjashtë dhjetë e pesë milion*) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a.
- Ankimues:** OE “G.A.C.” SHPK me NIPT L61619031A dhe me adresë, Rruga Pylla e Zeqirit, Nr Pas 211/158, ZK 1605, Sauk, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a. me adresë L.17 Rruga Dalip Peza, Durrës.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i dryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për*

*miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.02.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “*Procedure e Hapur - Punë publike (kontratë me çelsa në dorë)*” me Nr. REF-76024-02-12-2026, me objekt: “Furnizimi me ujë i zonës së Gjirit të Lalzit (*Kontratë me çelsa në dorë*)” me fond limit 65.000.000 (*Gjashtë dhjetë e pesë milion*) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.

II.2. Në datën 02.03.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 08.01.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “G.A.C.” sh.p.k	<b>59,607,243.00</b>	<b>I Skualifikuar</b>
2. BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k., & “Zenit&Co” sh.p.k	62,800,000.00	I Kualifikuar
3. “PE-VLA-KU” sh.p.k	64,348,944.00	I Skualifikuar

II.4. Në datën 19.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 20, datë 20.03.2026, ku është shpallur fitues BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k., & “Zenit&Co” sh.p.k.

II.5. Në datën 24.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6453 dhe me nr. 908/2026 prot., datë 25.03.2026 e operatorit ekonomik “G.A.C.” Shpk, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “G.A.C.” Shpk, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 908/1 prot., datë 25.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “G.A.C.” Shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit, të parashtruara në ankesën me nr. 908 prot., datë 25.03.2026.

II.7. Në datën 27.03.2026 nëpërmjet shërbimit postar, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 908/2 prot., datë 27.03.2026 e operatorit ekonomik “G.A.C.” Shpk, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “G.A.C.” Shpk, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Me shkresën përcjellëse me nr. 82/21 prot., me datë 30.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 908/3 prot., datë 31.03.2026, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “G.A.C.” SHPK” dërguar me postë elektronike, informacioni nga autoriteti kontraktor, mbi shqyrtimin e ankesës, ku ka vendosur mospranim.

II.9. Me shkresën përcjellëse me nr. 82/21 prot., me datë 30.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 908/4 prot., datë 03.04.2026, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “G.A.C.” SHPK” dërguar me shërbim postar, informacioni nga autoriteti kontraktor, mbi shqyrtimin e ankesës, ku ka vendosur mospranim.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “G.A.C.” Shpk, duke kundërshtuar skualifikimin e tij, referuar arsyes së dhënë nga autoritetit kontraktor: *“piken 2.3.5 të kapacitetit Teknik pasi: Nuk ka paraqitur fuqi punetore prej minimalisht 47 persona per periudhen, 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave. Referuar Kontrates se anagazhimit dhe shtojces 8, Formulareve Permbledhes te Vetedeklarimeve te OE SHANCI INVEST dhe GAC te ngarkuara ne SPE, verehet se OE SHANCI INVEST do te mbeshtes OE G.A.C me 27 punonje nga 47 te kerkuar ne piken 2.3.5, ne kundërshtim me piken 2 pragrafi 4 te nenit 90 te VKM nr 285/2021 Per miratimin e Rregullave te prokurimit Publik, i cili shprehet “ Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*“2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punetore prej minimalisht 47 persona per periudhen, 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave e vertetur kjo me:*

- *Vertetim te leshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj, per periudhen 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave.*

*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike si dhe dokumentacionit të dorëzuar në SPE, rezulton se OE “G.A.C.” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Kontratë angazhimi me shkrim me datë 02.03.2026, midis palëve “Shansi Invest” Shpk dhe “G.A.C.” Shpk.

- Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit të OE “G.A.C.” Shpk;

-Listëpagesën e Kontribute të Sigurimeve Shoqërore, shëndetësore dhe tatimet mbi të ardhurat nga Punësimi” për muajt Tetor-Nëntor-Dhjetor 2025 dhe Janar 2026 të OE “G.A.C.” Shpk;

-Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit të OE “Shansi Invest” Shpk;

- Licencë NZ.1495/24, regjistruar në regjistrim themeltar që nga data 13.02.2023, e vlefshme deri më 15.01.2028 për shoqërinë “Shansi Invest” Shpk;
- Vërtetim Nr.xxxxxx Datë 27.02.2026 “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a” për shoqërinë “Shansi Invest” Shpk;
- Listëpagesën e Kontribute të Sigurimeve Shoqërore, shëndetësore dhe tatimet mbi të ardhurat nga Punësimi” për muajt Gusht-Shtator-Tetor-Nëntor-Dhjetor 2025 dhe Janar 2026 për shoqërinë “Shansi Invest” Shpk;

III.1.3. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, operatori ekonomik ankimues “G.A.C” SHPK në pikën B “Deklaratë” në seksionin “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” ka deklaruar operatorin ekonomik “Shansi Invest” SHPK si subjekt, në kapacitetin e të cilit, do të mbështetet, konkretisht kjo pjesë është ngarkuar në sistem si më poshtë vijon:

**B: DEKLARATË**

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

1

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Kapaciteti teknik, licenca profesionale e shoqërisë.	Kategoria NP12A, NS16A, NS18A, NS20A, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftësi teknike	Eksperiencia në punë të ngjashme, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftësi teknike	Ing. Gjeolog, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftësi teknike	specialist ekspert zjarrfikës, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftësi teknike	Rreth 27 punonjës sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	AFTESI TEKNIKE	teknik ndertimi, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftësi teknike	karpentier, sipas dok bashkalidhur.

2

"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftesi teknike	R..... sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftesi teknike	konstruksione metalike, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftesi teknike	hekurkthyes, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftesi teknike	elektricitet, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftesi teknike	P..... kerksave per kualifikim, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftesi teknike	P..... sipas kerksave per kualifikim, sipas dok bashkalidhur
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftesi teknike	Eskavator me goma, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftesi teknike	Eskavator me cekic me zinxhir, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftesi teknike	Gjenerator, sipas dok bashkalidhur.
"SHANSI INVEST" Shpk.	J619240 02T	Aftesi teknike	Vibrator, sipas dok bashkalidhur.

III.1.4. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr.162/2022 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet se: "Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

III.1.5. Në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr.162/2020, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet se: "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."

III.1.6. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.7. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

*“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*

*2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.*

*3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

*4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.*

*5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.*

*6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.*

*7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”*

III.1.8. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*

*2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:*

*- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*

*- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*

*- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*

*- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.*

*3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.*

*4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.*

*5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.*

*6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.*

*7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”*

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj

autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjisllacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.10. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi. Marrë shkas nga pretendimet e ankimesit KPP vëren se në rastin konkret operatori ekonomik "G.A.C." Shpk ka deklaruar mbështetjen në kapacitetet e operatorit ekonomik "Shansi Invest" Shpk, referuar kjo, deklarimeve të bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konkretisht në pikën B, seksioni "*Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*". Gjithashtu në dokumentet e ofertës të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se subjekti mbi të cilin do të mbështetet, konkretisht për operatorin ekonomik "Shansi Invest" Shpk, është paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe kontratën e angazhimit midis palëve, si subjekt mbështetës i operatorit ekonomik "G.A.C." Shpk. Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar është përcaktuar qartë se: "*2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*" Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: "*4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.*" Në rastin konkret duke gjykuar se operatori ekonomik "G.A.C." Shpk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, "*Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori*

*ekonomik*” si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “Shansi Invest” Shpk, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik (Aftësitë teknike), KPP gjykon t’i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se: “4.Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.” Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri kualifikimi, operatori ekonomik “G.A.C.” Shpk ka ngarkuar në sistem (SPE) për veten e tij, Formularin Përmbledhës Vetëdeklarimi, Listëpagesën e Kontribute të Sigurimeve Shoqërore, shëndetësore dhe tatimet mbi të ardhurat nga Punësimi” për muajt Tetor-Nëntor-Dhjetor 2025 dhe Janar 2026. Ndërsa për operatorin ekonomik si subjekt mbështetës “Shansi Invest” Shpk ka ngarkuar në sistem Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit, Vërtetim Nr.xxxxxxx Datë 27.02.2026 “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a”, si dhe Listëpagesën e Kontribute të Sigurimeve Shoqërore, shëndetësore dhe tatimet mbi të ardhurat nga Punësimi” për muajt Gusht-Shtator-Tetor-Nëntor-Dhjetor 2025 dhe Janar 2026. Numri i punonjësve të deklaruar nga operator ekonomik “Shansi Invest” Shpk për tre muajt e fundit e përmbush kriterin e sipërcituar ndërsa Numri i punonjësve për 3 muajt e fundit të operatorit ekonomik “G.A.C.” Shpk si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera gjithashtu provon se plotëson 50% të kërkesës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik. KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar që ofertuesit të disponojnë, fuqi punëtorë prej minimalisht 47 persona për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave. Referuar parashikimit të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285, datë 19.01.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar duhet që “G.A.C.” Shpk si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera të plotësojë 50% të kërkesës më sipër pra kemi  $47 * 50\% = 23,5=24$  punonjës. Mbështetur në Formularin Përmbledhës Vetëdeklarimi, Listëpagesën e Kontribute të Sigurimeve Shoqërore, shëndetësore dhe taimet mbi të ardhurat nga Punësimi” për muajt Tetor-Nëntor-Dhjetor 2025 dhe Janar 2026, për operatorin ekonomik “G.A.C.” Shpk kemi:

**B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Deklarata	Përgjigje
-----------	-----------

9

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:	<b>Punonjës</b>
Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
	Nëse, po, numri i punonjësve
	<b>Nëntor 2025 – 27 punonjës</b>
	<b>Dhjetor 2025 - 27 punonjës</b>
	<b>Janar 2026 - 29 punonjës</b>
	Sipas dokumentacionit të paraqitur në tender.

Nga sa më sipër përlllogaritur, KPP konstaton se, fuqi punëtorë prej minimalisht 27-29 persona për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave të deklaruar nga operatori ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, i cili duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, e përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor për pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik. Në këtë kuadër, referuar të dhënave të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk si subjekt që mbështetet në kapacitetin e operatorit ekonomik “Shansi Invest” Shpk si edhe kërkesave për kualifikim, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk në këtë procedurë prokurimi është në përputhje me kriteret për kualifikim, fuqia punëtorë prej minimalisht 27-29 persona për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave të deklaruar nga ai, si subjekt që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, ku duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, e përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor të përcaktuar në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pavarësisht se operatori ekonomik “Shansi Invest” Shpk si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk e përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik, ky kriter do të koniderohet gjithashtu i përmbushur nga ofruesi “G.A.C.” Shpk, si subjekt që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, në këtë procedurë prokurimi sipas arsyetimit më sipër të KPP.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit “G.A.C.” Shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “G.A.C.” Shpk, duke kundërshtuar skualifikimin e tij, referuar arsyes së dhënë nga autoritetit kontraktor: *“OE nuk përmbush kriterin mbi Stafin Mbeshtetes pika 2.3.3 :*

• *piken 2.3.3 te kapacitetit Teknik, Staf Mbeshtetes: OE GAC ne Shtojcen nr.8 Formulari Permbledhes i Vetedeklarimit ne seksionin B ”Informacion mbi subjektin mbi kapacitetin, e te cilave do te mbeshtetet operatori ekonomik” ka deklaruar si subjekt mbeshtetes OE HTS COMPANY si dhe HE & SK 11.*

*Nga verifikimi ne SPE rezulton se OE HTS COMPANY dhe OE HE & SK 11 nuk kane paraqitur shtojcen nr 8 Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit. te dy OE jane persona juridik dhe me NIPT te ndryshem nga njeri tjetri.*

*Nga sa me sipër nuk është zbatuar neni 84 i LPP dhe neni 90 i VKM nr 285/2021 Per miratimin e Rregullave të prokurimit Publik. Si dhe Udhezimi i APP nr 1420 prot date 13.02.2025 drejtuar AK. Ku ndër të tjera shprehet:*

*OE i cili mbështetet në kapacitete të subjektit tjetër duhet të:*

- i. Deklaroj subjektin mbështetes.*
- ii. Dorezojë një deklaratë me shtj dhe subjektin mbështetes ku cëlohet angazhimi I marre ndërmjet tyre.*
- iii. Paraqesë F.P.V për subjektin mbështetes pasi duhet të provojë AK se nuk ekzistojnë shkaqe për skualifikim për përjashtim nga procedura sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-se.*

*OE nuk ka përmbushur KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES / KUALIFIKIMIT të përcaktuara në shtojcën 7 të DST -ve e cila shprehet:*

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.*

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.*

*Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetes.*

*Gjithashtu konstatohet se nga OE nuk është zbatuar pika 2 pragrafi 4 i nenit 90 të VKM nr 285/2021 Per miratimin e Rregullave të prokurimit Publik, i cili shprehet “ Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.*

*Pasi OE GAC nuk ka provuar se plotëson 50% të kërkesave të përcaktuara në STAFIN MBËSHETETES, por është mbështetur plotësisht (100%) tek subjekti mbështetes në kundërshtim me sa me sipër”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

*“2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:*

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi*
- 1 (një) Inxhinier Elektrik*
- 1 (një) Inxhinjer Hidroteknik*
- 1 (një) Inxhinier Mekanik*
- 1 (një) Inxhinjer Mjedis*
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog*
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshnajder*

*Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- Diploma*
- CV*
- Kontrata e punës*

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.*

#### *Staf Mbeshtetes*

*1 (Nje) Projektues Arkitekt (Licensa 2 a, d: Projektim arkitekturor për - objekte industriale - objekte turistike, Projektim peizazh, sisteme siperfaqe te gjelbera, lulishte e parqe.)*

*1 (Nje) Projektues Konstruktor (Licensa 3 a: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri ne 5 kate.)*

*1 (Nje) Projektues Instalator (Licensa 4 a,b,c,j:Projektim të instalimeve hidro-termosanitare, Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundra zjarrit- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industrial).*

*Stafi i sipërcituar është staf mbështetës përgatitjen e projektit të zbatimit (Faza I-II).*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projektme të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.*

*Për secilin punonjës te paraqitet diploma, kontrata e punes dhe CV.*

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.*

*Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.*

- ❖ Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjate gjith kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike si dhe dokumentacionit të dorëzuar në SPE, rezulton se OE “G.A.C.” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Formular Përmbledhës të Vetdeklarimit të OE “G.A.C.” Shpk;

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik**

*(nëse është e zbatueshme)*

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Informacione për nënkontraktorin</b></li> </ul>

1

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
HTS COMPANY HE&SK 11	M116190 18P.	Staf mbështetës	2ad, 3a, 4abcj, së bashku me arkitekt, instalator dhe konstruktor, sipas kërkesave për kualifikim,

-Licencë NZ.7351/7 të OE “G.A.C.” Shpk, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 30.05.2025, me vlefshmëri deri më datë 25.05.2026.

-Marrëveshje kontraktuale me shkrim me datë 26.02.2026, midis palëve shoqëria “HTS Company” Shpk & shoqëria HE& SK 11” Shpk & “G.A.C.” Shpk;

Shoqëria "HTS COMPANY" Shpk dhe "HE & SK 11" shpk, pranon të vëre në dispozicion të shoqërisë "G.A.C" Shpk, si dhe të bashkëpunoj lidhur kapacitet e mëposhtme të projektimit, si dhe shoqëria "G.A.C" Shpk pranon të mbështetet në kapacitet të shoqërisë "HTS COMPANY" Shpk dhe "HE & SK 11" shpk, si më poshte detajuar:

- 1 (Nje) Projektues Arkitekt (Licensa 2 a, d)
- 1 (Nje) Projektues Konstruktor (Licensa 3 a)
- 1 (Nje) Projektues Instalator (Licensa 4 a,b,c,j)

-Kontratë punë individuale me nr. xxxx rep., nr. Kol.xxx., datë 02.03.2023 lidhur midis shoqërisë "HTS Company" Shpk dhe Z. S.Ç., si drejtues teknik, profile inxhinier ndërtimi, me diplomë nr. xxx me titullin inxhinier për ndërtime civile industrial, Licencë K.xxxx në projektim regjistruar në regjistrin professional që nga data 25.06.2024, Cv;

-Kontratë punë individuale me nr. xxx rep., nr. Kol.xx., datë 18.02.2022 lidhur midis shoqërisë "HTS Company" Shpk dhe Z. R.M., si drejtues teknik, profile inxhinier elektrik, me diplomë nr. xxx me titullin inxhinier elektrik, Licencë E.xxx në projektim regjistruar në regjistrin professional që nga data 31.03.2022, Cv,

-Kontratë punë individuale me nr. xxx rep., nr. Kol.1xxx., datë 15.07.2025 lidhur midis shoqërisë "HTS Company" Shpk dhe Znj. A.M., si drejtuese teknike, profile inxhinier mekanik, me diplomë nr. xxx me titullin inxhinier mekanik për industrinë, Licencë M.xxx në projektim regjistruar në regjistrin professional që nga data 24.02.2023, Cv,

-Kontratë punë individuale me nr. xxx rep., nr. Kol.xxx., datë 27.01.2025 lidhur midis shoqërisë "HE&SK11" Shpk dhe Z. B.S., si drejtues teknik, profile arkitekt, me diplomë nr. xxx me titullin arkitekt, Licencë A.xxxxx në projektim regjistruar në regjistrin professional që nga data 06.03.2018, Cv,

-Licencë N.6703/25 në projektim regjistruar në regjistrin professional që nga data 30.09.2025, e vlefshme deri më datë 26.01.2030 për shoqërisë "HE&SK11" Shpk;

-Licencë N.7066/9 në projektim regjistruar në regjistrin professional që nga data 30.09.2025, e vlefshme deri më datë 17.06.2026 për shoqërisë "HTS Company" Shpk;

III.2.3. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr.162/2022 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet se: "Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

III.2.4. Në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr.162/2020, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet se: "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca

*konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.6. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

*“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*

*2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.*

*3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

*4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.*

*5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidarë për zbatimin e marrëveshjes.*

*6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen*

këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.2.8. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.2.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.10. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.3 të DT, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit dhe referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se ankimuesi ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit *B: Deklaratë "Informacion mbi subjektet mbi kapacitetini, e të cilëve do të mbështetet operatorit ekonomik"*, si subjekte mbi të cilët do të mbështetet në kapacitete në projektim, operatorin ekonomik "HTS Company" Shpk dhe operatorin ekonomik "HE&SK11" Shpk, shoqëruar me marrëveshje kontraktuale me shkrim me datë 26.02.2026 të tyre, të cilët angazhohen posaçërisht për të mbështetur operatorin ekonomik "G.A.C." Shpk me Kapacitetin teknik, Veprimtaria e projektimi sipas licences respektive dhe stafit inxhinierik projektues. Gjithashtu në sistem rezulton të jetë ngarkuar:

-Licencë N.6703/25 në projektim regjistruar në regjistrin profesional që nga data 30.09.2025, e vlefshme deri më datë 26.01.2030 për shoqërisë "HE&SK11" Shpk;

-Licencë N.7066/9 në projektim regjistruar në regjistrin profesional që nga data 30.09.2025, e vlefshme deri më datë 17.06.2026 për shoqërisë “HTS Company” Shpk;

Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është përcaktuar qartë se: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;” Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: “4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”.

Në rastin konkret duke gjykuar se, operatori ekonomik “G.A.C.” Shpk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “HTS Company” Shpk dhe operatorin ekonomik “HE&SK11” Shpk, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.3 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, KPP gjykon t’i drejtohet urdhërimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se: “4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.” Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik “G.A.C.” Shpk si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.3 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, ndërkohë ankimuesi “G.A.C.” Shpk rezulton të jetë mbështetur **plotësisht** te subjektet mbështetëse “HTS Company” Shpk dhe “HE&SK11” Shpk, të deklaruar si subjektë mbështetëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, çfarë bie ndesh edhe e parashikimet e dispozitës më sipër. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Komisioni gjykon se, duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar që jo vetëm duhet të deklarohet në dokumentet e ofertës mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera por janë

përcaktuar edhe kriteret për këtë mbështetje, njëri prej të cilëve është që në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, dispozitë e cila në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur nuk plotësohet nga ankimuesi pasi ai është mbështetur plotësisht te subjektet mbështetëse “HTS Company” Shpk dhe “HE&SK11” Shpk, lidhur me *Kapacitetin teknik pika 2.3.3 e DT.* Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon se, vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme të ankimuesit qëndrojnë pjesërisht dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk, pas arsyetimit të KPP do të vazhdojë të jetë “I skualifikuar”, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese, nuk ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik”*

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk, në procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur - Punë publike (kontratë me çelsa në dorë)*” me Nr. REF-76024-02-12-2026, me objekt: “Furnizimi me ujë i zonës së Gjirit të Lalzit (Kontratë me çelsa në dorë)” me fond limit 65.000.000 (*Gjashtë dhjetë e pesë milion*) lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “G.A.C.” Shpk.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtare**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

